

20160391004

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15 dhe 154/15), në nenin 22 në paragrafin (3) pas fjalës "nen" shtohen fjalët: "në afat prej 15 ditë nga dita e pranimi të aktvendimit".

Paragrafët (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19) dhe (20) shlyhen.

Neni 2

Në nenin 29 paragrafi (3) pika 5) në alinenë 4 pas fjalëve: "të kaluar" presja zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Në alinenë 5 lidhëza "ose" shlyhet, ndërsa presja zëvendësohet me pikëpresje.

Alineja 6 shlyhet.

Neni 3

Në nenet 76-v në paragrafin (4), 76-g në paragrafin (4), 76-d në paragrafin (4), 76-gj në paragrafin (4) dhe 76-e në paragrafin (4) fjalët: "ose Aptis" shlyhen.

Neni 4

Dispozita nga neni 1 i këtij ligji do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".